

Fletë udhëzuese mbi asistencën sociale

E drejta për të marrë asistencë sociale

Kush nuk mund të mbulojë me mjetet e veta në mënyrë të mjaftueshme ose në kohën e duhur jetesën për vete dhe për anëtarët e familjes me të njëjtin vendbanim, ka të drejtë të marrë ndihmë ekonomike (neni 15 i Ligjit mbi asistencën sociale).

Çfarë rëndësie ka kërkesa për marrjen e ndihmës?

Kërkesa për marrjen e ndihmës është baza për dhënien e ndihmës nga ana e Entit të përkujdesjes sociale. Kërkesa sidomos shërben për caktimin e ndihmave të mundshme të asistencës sociale. Zakonisht duhet ta nënshkruani kërkesën për marrjen e asistencës para se të merrni asistencë sociale. Përveç kësaj duhet të paraqitni një dokument aktual zyrtar të identitetit.

Detyrimi për të dhënë informacione

Kush kërkon asistencë sociale, është i detyruar të japë informacione të vërteta mbi gjendjen e tij lidhur me të ardhurat, pasurinë dhe familjen. Sidomos duhet të lejojë shikimin e dokumenteve dhe kontratave të qerasë, llogarive të rrogës, vendimeve gjyqësore etj. Për këtë qëllim kërkuesi duhet të dorëzojë me shkrim kërkesën për marrjen e ndihmës dhe dokumentet e kërkuara për shqyrtimin e kërkesës.

Për sqarime lidhur me ndihmën Shërbimi social respektivisht Sekretariati i përkujdesjes sociale mund të marrë informacione tek organet dhe institucione. Autorizimi i duhur për këtë marrje të informacioneve jepet me nënshkrimin e kërkesës për marrjen e ndihmës.

Çfarë bën pjesë në të ardhurat e llogaritshme?

- Të ardhurat kryesore dhe paralele me gjithë shtesat për familjen, fëmijët, rritjen e çmimeve, ndërresat e punës, kërkshëndellat, përfshirë provizionet, gratifikacionet, pensionet etj.
- Dhëniet financiare të çdo lloji si ulja e primeve të sigurimeve shëndetësore, pensionet e pleqërisë, e invaliditetit, pensionet për të venë dhe jetimet si dhe dietat ditore për shkak të sëmundjes, aksidentit, papunësisë, bursat dhe pagesat nga sigurimi ushtarak etj. (duhet të paraqitni polisat e sigurimeve dhe vërtetimet e sigurimeve të çdo lloji si p.sh. të sigurimeve shëndetësore, të aksidenteve, të jetës, të parakujdesjes profesionale, të dietave ditore, të gjësendeve shtëpiake dhe të përgjegjësisë).
- Dhëniet e njëhershme ose të rregullta nga persona privatë (p.sh. alimentacione, kontribute të prindërve, përkrahje nga ana e të afërmeve, pagesa nga ushqimia etj.), nga ndërmarrje, nga institucione shtetërore ose private bamirëse etj.
- Trashëgimitë, dhurimet, fitimet e çdo lloji në lotari etj.
- Shpagimet për dëme jomateriale nuk shërbejnë për sigurimin e mbijetesës materiale. Prandaj këto shpagime nuk llogariten. Ndërsa dëmshpërblimet materiale përfshihen në llogaritjen e nevojës për ndihmë.

Çfarë bën pjesë në pasurinë e llogaritshme?

- Paret, depozitat në bankë ose postë (edhe jashtë shtetit), aksionet, obligacionet, kërkesat ndaj të tretëve etj.
- Sendet me vlerë të çdo lloji (si vetura, stoli etj., edhe në qoftë se nuk janë më të reja).
- Patundshmëritë (edhe jashtë Zvicrës) si dhe të drejtat mbi to si banim, shfrytëzim etj.

Çfarë bëhet me borxhet dhe faturat e papaguara?

Asistenca sociale sipas parimit nuk i merr përsipër borxhet. Prapëseprapë ju lutemi që të na informoni për borxhet tuaja dhe faturat e papaguara, që të mund të gjehet zgjidhja më e mirë për ju (sh. faqen 4 të kërkesës për të marrë ndihmë). Flitni me doemos për këtë me këshilltaren ose këshilltarin kompetent/e. Përveç kësaj ju tërheqim vëmendjen që nuk lejohet që asistenca sociale të tjetërsohet, të jepet peng ose të merret peng.

Detyrimi për bashkëpunim

Personat të cilët kërkojnë ndihmë, janë të detyruar të bashkëpunojnë në sqarimin e gjendjes faktike dhe të lajmërojnë çdo ndryshim në gjendjen e tyre personale dhe financiare, për aq sa ndryshimet janë relevante për asistencën sociale (p.sh. fillimi i një pune, ndryshimi i orarit të punës, ndërrimi i vendit të punës ose të banesës etj.). Asistenca sociale mund të shkurtohet ose të ndalet plotësisht në rast të marrjes së ndihmës pa të drejtë, shkeljes së rëndë të obligimeve ose shpërdorimit të së drejtës. Shkurtimeve e tilla respektivisht ndalja duhet të komunikohen dhe të arsyetohen me shkrim në formën e një vendimi administrativ të kontestueshëm. Para kësaj marrësit të asistencës sociale duhet t'i jepet mundësia ligjore për t'u dëgjuar.

Detyrimi për të përkrahur të afërmit (neni 24 i Ligjit mbi asistencën sociale)

Obligimet e së drejtës familjare për dhënien e ushqimisë dhe përkrahjes sipas nenit 328 dhe nenit vijues të ZGB (Kodi Civil Zviceran) kanë përparësi para ndihmës ekonomike. Këto të drejta duhet të kërkohen sipas dispozitave të Kodit Civil Zviceran (ZGB).

Detyrimi për rikthimin e ndihmës (neni 25 i Ligjit mbi asistencën sociale)

Kush ka marrë ndihmë ekonomike, është i detyruar për ta kthyer atë, në qoftë se ka arritur marrjen e ndihmës duke paraqitur informacione jo të vërteta, ose në qoftë se gjendja e tij financiare është kthyer në një gjendje shumë të volitshme. E drejta për të kërkuar rikthimin përfshin ato ndihma të cilat marrësi i ndihmës i ka marrë për vete, për bashkëshortin/bashkëshorten gjatë martesës dhe për fëmijët gjatë periudhës kur kanë qenë të mitur. Kundrejt trashëgimtarëve të personave të cilët kanë marrë ndihmë ekonomike, detyrimi për rikthim shtrihet maksimalisht në trashëgiminë e marrë, duke patur parasysh gradën e farefisnisë dhe lidhjet personale me trashëgimlënësin. Ndihmën ekonomike, që dikush ka marrë për vete gjatë periudhës kur ka qenë i mitur ose deri në

përfundimin e një arsimimi të rregullt, nuk duhet ta kthejë. Për shumën që duhet të kthehet, nuk llogariten përqindje, dhe e drejta për rikthim shuhet pas 20 vitesh nga momenti i marrjes së ndihmës së fundit. Përkrahja nga ana e të afërmeve dhe rikthimi i ndihmave duhet të kërkohen nga organet e komunës që ka mbajtur shpenzimet.

Ndihma ekonomike, e cila është dhënë si parapagesë në pritje të pagesave nga një sigurim shoqëror, sigurim privat ose nga një i tretë (p.sh. pagesat nga IV) dhe për të cilat kryhen pagesa të mëpasme me efekt prapaveprues, duhet të kthehet. Komuna që jep parapagesën, mund të kërkojë nga sigurimi ose nga personi i tretë transferimin direkt të pagesës së mëpasme në lartësi të parapagesës së dhënë.

Zotësia juridike dhe aftësia për të vepruar

Fakti që një person merr asistencë sociale, nuk kufizon zotësinë e tij juridike dhe aftësinë juridiko-civile për të vepruar. Personi edhe si më parë sidomos mund të lidhë kontrata, të përpilojë një testament ose të bëjë procese. Asistenca nuk ka ndikim në ushtrimin e kujdesjes prindërore. Organeve të asistencës sociale u lejohet të themelojnë të drejta dhe detyrime në emër të personit të përkrahur vetëm atëherë kur janë autorizuar shprehimisht për këtë (p.sh. kërkimi i përkrahjes nga ana e të afërmeve).

Ndalimi i refuzimit ose vonimit të së drejtës, detyrimi për ruajtjen e fshehtësisë

Organeve të asistencës sociale nuk u lejohet të refuzojnë shprehimisht marrjen në dorëzim të kërkesës për ndihmë ekonomike ose të mos marrin duke heshtur një vendim mbi kërkesën për ndihmë ekonomike. As nuk u lejohet të vonojnë shqyrtimin e kërkesës më shumë se duhet.

Pjesëtarët e organeve të asistencës sociale dhe personat të cilët veprojnë në shërbimet sociale, i nënshtrohen detyrimit për ruajtjen e fshehtësisë (neni 5 i Ligjit mbi asistencën sociale) dhe i nënshtrohen detyrimit të zyrtarëve për ruajtjen e fshehtësisë në kuptimin e nenit 320 të Kodit Penal Zviceran.

E drejta ligjore për t'u dëgjuar dhe për shikimin e dosjes

Personat e përkrahur kanë të drejtë të shikojnë në dosjen e tyre, ata kanë të drejtën e orientimit, shprehjes dhe pjesëmarrjes në shqyrtimin e gjendjes faktike, të drejtën që kërkesa të shqyrtohet dhe vendimi të arsyetohet, si dhe të drejtën të përfaqësohen në procedurë nga një avokat.

Vendimi i arsyetuar me shkrim

Organet e asistencës sociale janë të detyruara të arsyetojnë me shkrim vendimet të cilat nuk aprovojnë kërkesën plotësisht, si dhe vendimet që janë ngarkuese. Arsyetimi duhet të jetë kështu që personi i prekur të jetë në gjendje të vlerësojë efektet e vendimit dhe eventualisht ta kontestojë atë – me dijeni të plotë të rrethanave – në instancën e kontestimit. Në vendim duhet të tregohen mendimet nga të cilat udhëhiqen organet e asistencës sociale, dhe ku bazohen.

Ndihma për të ndihmuar veten

Organet e asistencës sociale janë të detyruara t'u ofrojnë personave të prekur ndihma të tilla, të cilat i vëjnë ato në gjendje për të evituar emergjencën dhe për të përmirësuar respektivisht stabilizuar situatën e tyre.

Këshilla praktike

- Në qoftë se ndodhni në një situatë emergjente ose një e tillë ju shfaqet në horizont, drejtohuni ju lutemi me kohë Shërbimit social respektivisht Sekretariatit të përkujdesjes sociale. Këshillimi i hershëm është shumë i rëndësishëm për një ndihmë të efektshme!
- Shërbimit social respektivisht Sekretariatit të përkrahjes sociale u duhen të gjitha dokumentet të cilat vërtetojnë problemin tuaj (sh. listën e kontrollit): Llogaritja e rrogës (edhe për bashkëshorten/bashkëshortin), dokumentet lidhur me asistencën e papunësisë, vërtetime e bursave, kontratat e qirasë, dokumentet e sigurimeve shëndetësore etj. Mblidhni të gjitha dokumentet para bisedës dhe sillini ato me vete. Në këtë mënyrë mund të shqyrtohet më shpejt e drejta juaj për të kërkuar ndihmë.